



WESTMINSTER  
FOUNDATION FOR  
DEMOCRACY



# QEVERISJE ME INTEGRITET

Raport krahasues i kandidatëve me aktakuza në listat  
zgjedhore dhe kabinete qeveritare të viteve 2010, 2014 dhe  
2017

Western Balkans  
Democracy Initiative

 Funded by  
UK Government



Autor: Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD për Fondacionin e Uestminster për Demokraci me financim të Qeverisë së Britanisë së Madhe.

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi dhe Uestminster Foundation për Demokraci.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e donatorit.

## Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive .....	4
Hyrje.....	5
Praktikat ndërkombëtare dhe baza ligjore në Kosovë .....	6
1.    Ndalimi legjislativ .....	6
2.    Përrjashtimi institucional. ....	6
3.    Rregullat dhe politikat e partisë politike.....	6
Listat zgjedhore të partive politike me kandidatët me aktakuza .....	9
Zgjedhjet e vitit 2010.....	10
Zgjedhjet e vitit 2014.....	10
Zgjedhjet e vitit 2017.....	11
Kabinetet qeveritare që kanë pasur anëtarë me aktakuza .....	13
Qeveria e formuar nga zgjedhjet e vitit 2010 .....	14
.....	14
Qeveria e formuar nga zgjedhjet e vitit 2014 .....	15
Qeveria e formuar nga zgjedhjet e vitit 2017 .....	15
Konkludimet dhe rekomandimet.....	17

## Përmbledhja ekzekutive

Ky raport ka për qëllim verifikimin e numrit të personave me aktakuza dhe me gjykime gjyqësore për vepra penale, të cilët kanë qenë në lista zgjedhore për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe që kanë mbajtur pozita të kabinetet qeveritare në tri legjistraturat dhe periudhat qeverisëse në Kosovë 2010-2014, 2014 – 2017 dhe 2017 – 2019. Po ashtu, raporti bën analizë krahasuese për të konstatuar trendin e fenomenit të pranisë së personave me aktakuza dhe aktgjykime gjyqësore për vepra penale në lista zgjedhore dhe në funksione të larta shtetërore. Raporti është bazuar në hulumtime dhe krahasime të të dhënave nga burime institucionale.

Organizimi i zgjedhjeve në Kosovë gjithmonë ka përbërë sfida të veçantë për të gjitha institucionet të përfshira në këtë proces. Duke qenë në filllet e demokracisë, Kosova është ballafaquar me probleme të manipulimit dhe keqpërdorimit të procedit zgjedhor, veçanërisht në zgjedhjet e vitit 2010. Ndonëse në zgjedhjet pasuese ishte shënuar përmirësim i dukshëm në organizimin e zgjedhjeve, fatkeqësisht listat e kandidatëve për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës në vitet 2014 dhe 2017 kanë pësuar degradim në aspektin e përfshirjes së personave, mbi të cilët rëndojnë aktakuza për vepra penale.

Pas hulumtimit të bërë, ky raport ka gjetur se në zgjedhjet e vitit 2010 kishte dy kandidatë me aktakuzë që garonin për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në zgjedhjet nacionale të vitit 2014, ky numër është rritur nga dy në pesëmbëdhjetë (15). Ndërsa në zgjedhjet nacionale të vitit 2017 gjendja përkeqësohet më tutje me gjithsej njëzet e shtatë (27) persona në lista të kandidatëve për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prania e personave me aktakuza apo aktgjykime për vepra penale nuk ka ndaluar vetëm në Kuvend, por është reflektuar edhe në ekzekutiv, pra në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, kabineti qeverisës në periudhën 2010 – 2014 ka pasur dy pozita të larta me aktakuza, njëjtë sikurse edhe kabineti qeverisës në periudhën 2014 – 2017. Ndërsa, në periudhën 2017 – 2019 kemi degradimin më të madh me 14 zyrtarë të lartë të shtetit me aktakuza në pozita si zëvendëskryeministër, ministër dhe zëvendësministër.

Para zgjedhjeve lokale të vitit 2017, KQZ kishte bërë përpjekje për decertifikimin e kandidatëve me aktakuza në zgjedhjet komunale. Mirëpo vendimi i KQZ-së, ndonëse me bazë ligjore, ishte rrëzuar nga Gjykata Supreme e Kosovës pas ankesës së disa kandidatëve të deçertifikuar me arsyetimin se në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor.

WFD dhe IKD kishin ngritur vetëdijen dhe avokuar tash e dy vite për adresimin e këtij problemi, duke ofruar shembuj nga praktikat më të mira ndërkombëtare dhe përkrahje, por partitë politike nuk kanë shprehur vullnet politik për të adresuar këtë problem.

## Hyrje

Në Kosovë, tash e sa vite kemi parë anëtarë të caktuar të partive politike, të cilët kanë probleme me ligjin dhe kandidojnë e mbajnë poste publike. Kjo dukuri negative është e dëmshme për Kosovën dhe qytetarët e saj për shumë arsye. Ne do të përmendim disa prej tyre.

Së pari, partitë politike janë bartës të proceseve shoqërore të çdo vendi demokratik. Rrjedhimisht, nga anëtarët e partive politike pritet të shfaqin dhe të promovojnë vlerat më të larta morale të shoqërisë ku jetojnë. Veprimet e politikanëve në çdo nivel duhet të jenë të dinjitetshme, me integritet dhe të përgjegjshme. Prania e personave që kanë probleme me ligj në lista zgjedhore dhe në pozita institucionale bie ndesh me këtë vlerë demokratike dhe dëmton imazhin e partive politike.

E dyta, ndoshta më e rëndësishmja, kur personat që kanë aktakuzë ose aktgjykime gjyqësore për vepra penale marrin pozita të larta në kabinet qeveritar ose si deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, këta persona menaxhojnë me shuma të mëdha të mjeteve të mbledhura nga taksat e qytetarëve të Kosovës. Kjo paraqet një rrezik të madh për keqpërdorimin e taksave të qytetarëve.

E treta, ka të bëjë integrimin evropian dhe marrëdhëniet me jashtë. Kosova është duke kaluar nëpër procesin e integritimit evropian. Standardet e BE-së janë mjaft të qarta në këtë drejtim, dhe kërkojnë sundim të plotë të ligjit. Mbajtja e pozitave të larta shtetërore nga persona që kanë probleme me ligjin bie ndesh parimin e sundimit të ligjit. Për më tepër, në rrafshin ndërkombëtar, këta persona i japin një imazh shumë të keq Kosovës.

Duhet të potencohet se Kosova nuk është unike sa i përket kësaj dukurie negative. Shumë shtete nëpër botë kanë pasur sfida të tilla dhe këtë e kanë rregulluar në mënyra të ndryshme. Edhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe ato që aspirojnë anëtarësimin kanë dispozita ligjore apo rregulla tjera për parandalimin apo largimin e personave me dosje penale nga kandidimi në zgjedhje dhe mbajtja e posteve publike.

## Praktikat ndërkombëtare dhe baza ligjore në Kosovë

Gjatë vitit 2018, Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD) dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi kanë prezantuar dy raporte për të ngritur vetëdijën rreth kësaj dukurie dhe për të ofruar zgjidhje teorike dhe praktike. Raporti i WFD ka ofruar përvojat ndërkombëtare të zgjedhjes së kësaj problematike, ndërsa Raporti i IKD-së rekomandimet në bazë të legjislacionit dhe rrethanave të Kosovës. Më poshtë është bërë një përmbledhje e shkurtër e dy raporteve.

Shtetet e ndryshme të Bashkimit Evropian dhe tjera, kanë adresuar këtë problem në tri mënyra kryesore. Ato janë:

1. **Ndalimi legjislativ.** Sipas këtij rregullimi, shteti miraton në kushtetutën e vendit, legjislacion tjetër ose në të dyja, kufizime për adresimin e këtij fenomeni. Shtetet miratojnë dispozita ligjore të cilat e parandalojnë pjesëmarrjen në zgjedhje qoftë në bazë të cilësisë së veprës qoftë në bazë të kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar.
2. **Përrjashtimi institucional.** Kjo qasje i jep të drejtë institucioneve të zgjedhura si parlamenti dhe organet tjera që të përjashtojnë të zgjedhurit politik për shkak të papërshtatshmërisë. Kjo do të thotë se pavarësisht se një kandidat fiton në zgjedhje, institucioni që ka rregulla të larta etike mund të mos lejojë kandidatin të marrë postin publik.
3. **Rregullat dhe politikat e partisë politike.** Përmes këtij opsioni, partitë politike miratojnë rregulla brenda statuteve të tyre, ose kode të veçanta etike, që parashohin parandalimin dhe përjashtimin e qytetarëve me aktakuza ose aktvendime gjyqësore nga anëtarësimi në parti, pozitat udhëheqëse dhe nga nominimi si kandidat i partisë në zgjedhje. Në këtë mënyrë, nëse një anëtar i partisë bën veprime joetike ose ndaj anëtarit ngritet aktakuzë atëherë partia e suspendon përkohësisht ose e përjashton nga partia. Në të njëjtën kohë, kjo rezulton edhe me humbje të postit publik nëse i akuzuari ka mbajtur një pozitë të tillë.

Në anën tjetër, Raporti i IKD-së pas analizës së bërë rreth kësaj dukurie në rrethanat e Kosovës ka konkluduar se për ndalesë legjislative, pra rregullim ligjor, është i domosdoshëm amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës për shkak të kolizionit ligjor të Kushtetutës me legjislacionin që e rregullon fushën e zgjedhjeve. Ky proces mund të zgjasë shumë, të has në vështirësi dhe mund të vonojë shumë procesin e dekriminalizimit.

Prandaj, nga opsionet e përjashtimit institucional dhe rregullimit përmes statuteve të partive apo kodeve etike, kjo e fundit duket më e realizueshme duke e parë nevojën urgjente për adresim të këtij problemi. Për këtë nevojitet vetëdijësim i klasës politike për të larguar personat me aktakuza, me aktvendime gjyqësore dhe të tjerë që kanë probleme me ligjin nga partitë përkatëse.

Përpos kolizionit ligjor të konstatuar ndërmjet Kushtetutës dhe legjislacionit primar, situata është komplikuar në shtator të vitit 2017, kur KQZ duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, kishte marrë vendim për deçertifikimin e të gjithë kandidatëve që kishin garuar për Kryetar të Komunave dhe asamble komunale për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017. Deçertifikimi vlente për kandidatët në zgjedhje që kishin aktgjykim dënues të formës së prerë nga Gjykatat e Kosovës.

Ndaj vendimit të KQZ-së, disa nga kandidatët e deçertifikuar kishin paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme kishte miratuar ankesën e kandidatit nga subjekti politik NISMA, i cili kishte kandiduar për kryetar të komunës së Prizrenit.

Përmes Aktgjykimit AA-Uzh. Nr. 16/2017, Gjykatës Supreme, me 19 shtator 2017, vendos se askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë se kandidati duhet me vendim të formës së prerë të gjykatës të shpallet fajtor dhe gjykata t'i ketë shqiptuar edhe dënim plotësues "heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur". Si rrjedhojë, KQZ ishte obliguar, të bëjë çertifikimin e kandidatit të subjektit politik NISMA për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme po ashtu, kishte konstatuar se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, ku sipas interpretimit të kësaj gjykate kur në një anë kemi normën kushtetuese, e cila përcakton se e drejta për të garuar në zgjedhje mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor dhe në anën tjetër kemi nenin 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që parasheh mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte pa vendim gjyqësor, atëherë mbizotëron Kushtetuta si akt më i lartë juridik.

Si rezultat i interpretimit të Gjykatës Supreme dhe paqartësisë ligjore, respektivisht Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme vetëm në zgjedhjet lokale të mbajtura më 22 tetor 2017, janë çertifikuar dhe kanë kandiduar mbi 600 persona me të kaluar kriminale për kryetar komune apo asamble komunale.<sup>1</sup>

Kodi Penal i Republikës së Kosovës i rishikuar ka hyrë në fuqi më 14 prill 2019.<sup>2</sup> Edhe pse i ndryshuar, dispozitat e Kodit lidhur me kufizimin drejtës për t'u zgjedhur janë identike me dispozitat e Kodit Penal që ka qenë i zbatueshëm në Kosovë. Kodi Penal, parasheh tre lloj dënimesh ndaj kryesve të veprave penale: dënimin kryesor, alternativ dhe plotësues. Dënimet plotësuese mund të shqiptohen së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.

---

<sup>1</sup> "IKD reagon ndaj shkeljes së ligjit nga KQZ, kërkon largimin e kandidatëve të certifikuar që kanë aktgjykime dënuese përfundimtare dhe fton Prokurorin e Shtetit të hetojë vendimmarrjen e KQZ-së". Instituti i Kosovës për

Drejtesi. 10 shtator 2017. (Shih linkun: <http://kli-ks.org/ikd-reagon-ndaj-shkeljes-se-ligjit-nga-kqz-kerkon-largimin-e-kandidateve-te-certifikuar-qe-kane-aktgjykime-denuese-perfundimtare-dhe-fton-prokurorin-e-shtetit-te-hetoje-vendimmarrjen-ekqz-se/> )

<sup>2</sup> "KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS", i miratuar më 28 nëntor 2018 nga Kuvendi i Kosovës (shih linkun: <https://qzk.rks-qov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18413>).



Në kuadër të dënimeve plotësuese, është paraparë edhe heqja e të drejtës për t'u zgjedhur. Sipas nenit 60 të këtij kodi, gjykata mund t'ia heq kryesit të veprës penale të drejtën për t'u zgjedhur prej një (1) deri në katër (4) vjet, nëse ai person, me qëllim që të zgjidhet, kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku dy (2) vjet burgim.

Përderisa sipas këtij kodi, ekzekutimi i dënimeve plotësuese fillon së bashku me ekzekutimin e dënimit kryesor ose të dënimit alternativ. Ekzekutimi i dënimit plotësues lidhur me heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur fillon pas mbajtjes së dënimit me burgim dhe se gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, personi i dënuar nuk mund t'i gëzojë të drejtat e kufizuara nga dënimi plotësues.

Mirëpo, me vendimin e Gjykatës Supreme AA.-Uzh.nr. 16/2017, të datës 19 shtator 2017, askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë se kandidati duhet me vendim të formës së prerë të gjykatës të shpallet fajtor për vepër penale kundër të drejtave të votimit ose vepër tjetër penale të dënueshme deri në dy (2) vite, e cila mund të kryhet me qëllim që të zgjedhet, dhe gjykata t'i ketë shqiptuar edhe dënim plotësues "heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur".

Në këtë drejtim, praktika gjyqësore e ndërtuar nga Gjykata Supreme, dispozitat ligjore lidhur me ndalimin legjislativ të përcaktuar qoftë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme por edhe me Kodin Penal të Kosovës, i konsideron si kundër kushtetuese dhe jo të zbatueshme.

Përveç kësaj, Kodi i Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venedikut përcakton kritere kumulative për heqjen e së drejtës për t'u zgjedhur, e të cilat kritere përfshijnë obligimin se duhet të parashihet me ligj, duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit, duhet të jetë i bazuar në dënim për vepër penale të rëndë dhe duhet të shqiptohet nga gjykata.

## Listat zgjedhore të partive politike me kandidatët me aktakuza

Persona të shumtë, vazhdojnë të përballen me drejtësinë për vepra të ndryshme penale që dyshohet t'i kenë kryer gati një dekadë më parë që ndërlidhen me veprat penale të zgjedhjeve. E sidomos, viti 2010, karakterizohet se ka qenë njëra nga njollat më të errëta të Kosovës së pasluftës për organizimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike, pasi që në atë kohë, nga të gjitha raportet vendore e ndërkombëtare, një procesi i tillë ishte vlerësuar minimalisht për shkak të vjedhjes industriale të votave.

Si rezultat i këtyre manipulimeve të vazhdueshme, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës me ndihmën e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) kishin hartuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për të rritur efikasitetin dhe efektivitetin e këtyre institucioneve për të reaguar në parandalimin dhe luftimin e kryerjes së veprave penale që ndërlidhen me zgjedhjet. Rrjedhimisht, në vitet pasuese, ishte shënuar përmirësim në organizimin e zgjedhjeve, sidomos pas aplikimit të Procedurave Standarde të Veprimit.<sup>3</sup>

Përmirësimet në këtë aspekt të organizimit të zgjedhjeve, fatkeqësisht nuk janë përcjellë me të njëjtin ritëm nga vetë partitë politike. Kjo sepse, me kalimin e viteve kemi rritje të personave të cilët kanë kandiduar në zgjedhjet nacionale, e që gjatë asaj periudhe kohore kanë pasur të ngritura aktakuza apo procese gjyqësore duke u zhvilluar ndaj tyre.

IKD dhe WFD vazhdimisht kanë ngritur çështjen e dekriminalizimit të politikës në Kosovë. Në shkurt të vitit 2018, WFD në partneritet me IKD-në kanë organizuar tryezën me titull “Iniciativa për Dekriminalizimin e Politikës”, me pjesëmarrjen e të disa subjekteve politike dhe akterëve të tjerë institucional<sup>4</sup> ku edhe u publikua raporti “Studim Krahasues i Dekriminalizimit të Politikës”, që paraqet praktikat më të mira ndërkombëtare në adresimin e kësaj dukurie. Më pas, në tetor të vitit 2018, IKD publikon raportin “Dekriminalizimi i Politikës në Kosovë”<sup>5</sup> në një tryezë për të diskutuar me partitë politike dhe shoqërinë civile këtë problematikë.

Në vazhdim janë paraqitur, numri i kandidatëve të akuzuar për çdo parti dhe veprat penale përkatëse për secilin vit të zgjedhjeve nacionale të organizuara në vitet 2010, 2014 dhe 2017.

---


<sup>3</sup> “Aktgjykimet e vitit 2018, dënime me kusht ndaj të akuzuarve për manipulim e keqpërdorim në zgjedhje”. Betimi për Drejtësi. 7 Janar 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykimet-e-vitit-2018-denime-me-kusht-ndaj-te-akuzuarve-per-manipulim-e-keqperdorim-ne-zgjedhje/>)

<sup>4</sup> “Kërkohet rregullim ligjor ose etik për dekriminalizimin e politikës në Kosovë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. 20 shkurt 2018. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/kerkohet-rregullim-ligjor-ose-etik-per-dekriminalizimin-e-politikes-ne-kosove/>).

<sup>5</sup> Shih <https://kli-ks.org/dekriminalizimi-i-politikes-ne-kosove/>

## Zgjedhjet e vitit 2010

Në zgjedhjet e vitit 2010, në garën për t'u bërë deputet kishin kandiduar dy (2) persona të cilët kishin aktakuza. Të dy kandidatët nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), të cilët në atë kohë ishin në proces lidhur me aktakuzën që ata i ngarkonte për krime lufte. Nga dy kandidatët njëri prej tyre ishte zgjedhur deputet në Kuvend.




**Grafikoni 1 - Numri i kandidatëve me aktakuza në zgjedhjet e vitit 2010.**

## Zgjedhjet e vitit 2014

Në zgjedhjet e vitit 2014, kishte një trend të rritjes së kandidatëve për deputetë mbi supet e të cilëve rëndonin vepra të ndryshme penale. Në këto zgjedhje ishin gjithsej 15 kandidatë me aktakuza, nga të cilët pesë (5) vinin nga PDK-ja, tre (3) që akuzoheshin për krime lufte, një (1) për mos raportim të pasurisë, ndërsa një (1) për vjedhje të rëndë. LDK – ja kishte dy (2) kandidatë të cilët akuzoheshin për vepra penale korruptive.

Nga LVV-ja, ishin pesë (5) kandidatë me aktakuza, tre (3) nga ta të akuzuar për “lëndim të lehtë trupor”, ndërsa dy (2) të tjerë për veprën penale “pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm” dhe “asgjësim apo dëmtim i pasurisë”. NISMA për Kosovën i kishte dy (2) kandidatë të akuzuar në atë kohë, njëri që akuzohej për krime të luftës, krim të organizuar e korrupsion dhe përpos tij, akuzohej edhe një kandidat tjetër për veprën penale “lidhje e paautorizuar në shërbime”.

Ndërsa për “mos raportim të pasurisë”, akuzohej një kandidate nga komunitetet joshumicë, që i takonte partisë Vakrat.



**Grafikoni 2 - Numri i kandidatëve me aktakuza në zgjedhjet e vitit 2014.**

Nga gjithsej 15 kandidatë me aktakuza, 12 prej tyre ishin bërë deputetë.<sup>6</sup>

## Zgjedhjet e vitit 2017

Listat zgjedhore të vitit 2017, janë shembulli më i keq nga të gjitha zgjedhjet e deritashme për shkak të numrit të lartë të kandidatëve me aktakuza. Në këto lista ishin 27 kandidatë për deputet mbi të cilët rendonin aktakuza.

Në këto zgjedhje për shkak të veprimeve protestuese të tyre në Kuvendin e Kosovës rreth marrëveshjeve të Kosovës me Malin e Zi për Demarkacionin dhe atë për Asociacionin e komunave serbe, një numër i konsiderueshëm i aktakuzave kishin të bënin me hedhjen e gazit lotsjellës dhe pengimin e personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare.

Megjithatë krahas këtyre veprave kishte edhe kandidatë të tjerë për deputet të cilët akuzoheshin për korrupsion e vepra të tjera penale.

Nga 27 kandidatët me aktakuza, 15 nga i takonin LVV-së, katër (4) nga të cilët akuzoheshin për vepër terroriste, ndërsa njëmbëdhjetë (11) të tjerë akuzoheshin për veprën penale “pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizëm”, “asgjësim apo dëmtim i pasurisë”, “përdorim i armës” dhe “pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”.

<sup>6</sup> Prej këtyre 12 kandidatëve të zgjedhur si deputetë, 4 kanë dhënë dorëheqje (3 për shkak të dënimit të formës së prerë lidhur me rastet e tyre penale respektive, ndërsa 1 ka kaluar në ekzekutiv si zv. Kryeministër).

Për veprat penale “përdorim i armës” dhe “pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare”, akuzoheshin edhe pesë (5) kandidatë të AAK-së, njëri nga të cilët bënte pjesë edhe në dy aktakuza për korrupsion. Ndërsa për keqpërdorim të pozitës zyrtare akuzohej edhe një kandidatë.


Nga radhët e partisë NISMA për Kosovën, akuzoheshin dy (2) kandidatë, ndaj njërit rëndonin dy aktakuza, njëra për veprat penale të krimit të organizuar e korrupsionit si dhe në një aktakuzë tjetër për krime të luftës. Ndërsa kandidati tjetër akuzohej për veprën penale “përdorim i armës dhe pengim i personit zyrtar”.

LDK-ja kishte dy (2) kandidatë me aktakuza, ku njëri akuzohej në dy raste, pra kishte dy aktakuza të ngritura ndaj tij – njëren për veprat penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, ndërsa tjetrën për “shmangie nga tatimi” dhe “shpërdorim”. Ndërsa, i akuzuari tjetër ngarkohej për veprën penale “vjedhje e rëndë”.

Nga PDK-ja ishte një (1) kandidat i cili akuzohej për veprën penale “mundësimi i arratisjes së privuar nga liria”.

Ndërsa, nga Partia e Ashkalinjve për Integrim aktakuza kishin dy (2) kandidatë.


Prej këtyre listave, kishin arritur të zgjidhen në tërësi 21 deputetë, pra pavarësisht se kishin aktakuza, ata janë votuar nga votuesit.



**Grafikoni 3 - Numri i kandidatëve me aktakuza në zgjedhjet e vitit 2017.**

Karakteristikë e kësaj legjislature, ishte se një numër i deputetëve, pas marrjes së mandatit ishin akuzuar nga Prokurori i Shtetit. Janë tetë (8) deputetë të cilët janë akuzuar për vepra të ndryshme penale, duke filluar prej sulmit deri te veprat e korrupsionit. Tre (3) prej deputetëve të akuzuar ishin nga AAK, dy (2) nga PDK dhe nga një (1) prej NISMA, PSD dhe Partia e Bashkuar Gorane.

Legjislatura 2017-2019



## Kabinetet qeveritare që kanë pasur anëtarë me aktakuza

Pëveç pranisë së personave me aktakuza në Kuvendin e Kosovës, persona të tillë ka pasur edhe në kabinetet qeveritare në periudha 2010-2014, 2014-2017 dhe 2017-2019. Këta kanë pasur aktakuza të ndryshme për vepra penale, kryesisht për korrupsion dhe që në të njëjtën kohë kanë ushtruar pozitat e larta duke filluar prej pozitës së zëvendëskryeministrit, ministrit e zëvendësministrit.

Kësisoj, ekzekutivi i dalë prej zgjedhjeve të vitit 2010 kishte dy pozita të larta me aktakuza. Njëjtë ishte edhe në ekzekutivin 2014, ku ishin dy përfaqësues në qeveri që kishin aktakuza. Ndërsa, deragimi më i madh kishte ndodhur në qeverinë e dal prej zgjedhjeve 2017, në të cilën ishin 14 zyrtarë të lartë të shtetit që kanë pasur aktakuza dhe që në të njëjtën kohë kanë ushtruar pozitat e larta duke filluar prej pozitës së zëvendëskryeministrit, ministrit e zëvendësministrit.


IKD në vazhdim ka paraqitur, për secilën qeveri të dalë prej zgjedhjeve nacionale të organizuara në vitet 2010, 2014 dhe 2017, numrin e përfaqësuesve që kanë pasur aktakuza dhe që kanë ushtruar pozita në Qeveri, duke filluar prej pozitës së zëvendëskryeministrit, ministrit e zëvendësministrit. Natyrisht, në këtë pjesë IKD ka paraqitur vetëm zyrtarët e akuzuar në këto pozita, ndërsa numri i zyrtarëve publik në të gjitha dikasteret qeveritare nën pozitën e ministrit e tutje është dhjetëra herë më i madh.

## Qeveria e formuar nga zgjedhjet e vitit 2010

Në legjislaturën, e cila doli nga zgjedhjet nacionale të vitit 2010, në lista zgjedhore ishin dy kandidatë, të cilët kishin aktakuza dhe gjendeshin në procedura gjyqësore lidhur me aktakuzat për krime lufte. Njëri prej tyre u votua dhe u bë deputet. Të dy këta kandidatë ishin nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Sidoqoftë për këto zgjedhje, kishte kontestim të madh të mandateve, të cilat buruan nga një proces i manipulimeve të votave, pas të cilit, rreth tre mijë komisionerë të partive politike u akuzuan për manipulim të votave.

Situatë e njëjtë ka rezultuar edhe në ekzekutivin e prodhuar nga ky Kuvend i dal prej zgjedhjeve të vitit 2010. Ishin dy përfaqësues në Qeverinë e Kosovës, të cilët kishin aktakuza, ishte një zëvendëskryeministër dhe një zëvendësministër, të dy të akuzuar për vepra penale të korrupsionit. Të dy zyrtarët qeveritar ishin nga “Lista Rugova”.




**Grafikoni 4: Numri i anëtarëve me aktakuza në kabinetin qeveritar 2010-2014**

## Qeveria e formuar nga zgjedhjet e vitit 2014

Në zgjedhjet nacionale të vitit 2014, kishte një trend të rritjes së kandidatëve për deputetë, të cilët kishin aktakuza, ishin gjithsej 15 kandidatë me aktakuza, prej të cilëve 12 ishin bërë deputetë<sup>7</sup>.

Në ekzekutivin e prodhuar nga Kuvendi i dal prej zgjedhjeve të vitit 2014, kishte dy ministra që kishin aktakuza. Njëri ishte ministër nga Lista Serbe dhe tjetër ministër nga Partia e Drejtësisë. Ky i fundit, në momentin e ngritjes së aktakuzës ka ofruar dorëheqje.



**Grafikoni 5: Numri i anëtarëve me aktakuza në kabinetin qeveritar 2014-2017**

## Qeveria e formuar nga zgjedhjet e vitit 2017

Sikurse është theksuar më lartë në këtë raport, në zgjedhjet e vitit 2017 për shkak të veprimeve protestuese të tyre në Kuvendin e Kosovës rreth marrëveshjeve të Kosovës me Malin e Zi për Demarkacionin dhe atë për Asociacionin e komunave serbe, një numër i konsiderueshëm i aktakuzave kishin të bënin me hedhjen e gazit lotsjellës dhe pengimin e personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, ndërsa pjesa tjetër akuzoheshin për korrupsion e vepra të tjera penale. Në total ishin 27 kandidatët me aktakuza. Prej tyre 21 kishin arritur të bëhen deputetë.

Në ekzekutivin e prodhuar nga Kuvendi i dal prej zgjedhjeve të vitit 2017, kishte më së shumti përfaqësues në Qeveri që kishin aktakuza.


Ishin 14 përfaqësues në Qeveri që kishin aktakuza, duke filluar prej një (1) zëvendëskryeministri, shtatë (7) ministrave dhe gjashtë (6) zëvendësministrave. Katër (4) prej tyre ishin nga AAK, tre (3) prej tyre ishin nga PDK, tre (3) prej tyre ishin nga Nisma,

---

<sup>7</sup> Po aty.




dy (2) prej tyre ishin nga AKR, një (1) nga Lista Rugova dhe një (1) nga Partia e Ashkalinjëve për Integrim.



**Grafikoni 6: Numri i anëtarëve me aktakuza në kabinetin qeveritar 2017-2019**

## Konkludimet dhe rekomandimet

Studimi dhe krahasimi i listave zgjedhore të viteve 2010, 2014 dhe 2017 duke u bazuar në burime institucionale konkludon se ka trend në rritje të përfshirjes së personave me aktakuza në zgjedhje në Kosovë.




**Grafikoni 7: Krahasimi i kandidatëve me aktakuza në zgjedhjet e viteve 2010-2014-2017**

Ky trend është jashtëzakonisht shqetësues për shkak të përkeqësimit konstant përgjatë viteve. Përpos që dëmton imazhin e partive politike, ky imazh negativ është bartur edhe në institucionin më përfaqësues shtetëror, pra Kuvendin e Republikës së Kosovës.

I njëjti trend negativ vërehet edhe për kabinetet qeveritare përgjatë viteve. Për më tepër, në shumë raste edhe pse zyrtarët e lartë të partive politike në momentin e emërimit në poste të larta qeveritare nuk kanë pasur aktakuza, gjatë shërbimit të tyre ndaj tyre është ngritur aktakuzë dhe kanë vazhduar punën.

Sikur në rastin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, puna e personave me aktakuza në kabinet qeveritar e dëmton rëndë imazhin e Qeverisë së Republikës së Kosovës si brenda ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Një gjë tjetër shqetësuese është se këta persona me aktakuza menaxhojnë me shuma të larta të buxhetit të Kosovës të mbledhura nga taksat e qytetarëve, që paraqet rrezik për keqpërdorimin e tyre.



**Grafikoni 8: Krahasimi i anëtarëve me aktakuza në kabinetet qeveritare 2010-2019**

Prandaj, në bazë të të gjeturave të mësipërme, rekomandohet që:

- Partitë të mos përfshijnë në lista të kandidatëve për zgjedhjet e vitit 2019 persona që kanë probleme me ligj, do të thotë persona që janë nën hetime, me aktakuzë ose me aktvendim gjyqësor;
- Kabineti qeveritar që rrjedh nga zgjedhjet e vitit 2019 të mos ketë persona që janë nën hetime, me aktakuzë ose me aktgjykim gjyqësor;
- Pas përfundimit të zgjedhjeve, liderët e partive të ndërmarrin iniciativë të përbashkët ose individuale për të adresuar këtë dukuri negative një herë e përgjithmonë.

Opsionet e rekomanduara për adresimin e kësaj dukurie në bazë të praktikave ndërkombëtare dhe rrethanave të Kosovës janë:

1. Miratimi i rregullave etike. Kjo mund të realizohet me një iniciativë të përbashkët të partive politike përmes miratimit të një Kodi Etik i cili do të aplikohet nga të gjitha partitë; ose secila parti politike të miratojë rregulla etike brenda statuteve të tyre ose si akt i veçantë me dispozita të qarta për largimin e çdo anëtari të partisë, nga funksionet partiake dhe shtetërore, nëse ndaj anëtarit ngritet aktakuzë apo ka aktvendim gjyqësor për vepra penale. Miratimi i Kodeve të Etikës do të kishte karakter obligativ, vet rregullues dhe përjashtues ndaj individëve që kanë probleme me ligjin. Kodet e Etikës mund të marrin për bazë dhe të përfshijnë parimet e ndërtuara nga Komisioni i Venedikut dhe shtetet me përvojë të gjatë të demokracisë parlamentare
2. Ndalesa legjislative. Kjo mund të realizohet përmes një iniciative ligjore të ndryshimit të një numri të akteve ligjore. Në situatën aktuale të krijuar në Kosovë veçanërisht pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, dispozita ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme por edhe të Kodit Penal të Kosovës, konsiderohen si kundër kushtetuese dhe jo të zbatueshme. Prandaj për të adresuar këtë dukuri përmes ndalesave legjislative është i domosdoshëm amandamenti i Kushtetutës dhe i ligjeve të lartpërmendura.<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> “Dekriminalizimi i politikës në Kosovë”. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD). Tetor, 2018. fq. 19



WESTMINSTER  
FOUNDATION FOR  
DEMOCRACY

# Western Balkans Democracy Initiative

Westminster Foundation  
for Democracy (WFD)

[www.wfd.org/wbdi](http://www.wfd.org/wbdi)

